



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



ERSTE Stiftung



Memorandum i Mirëkuptimit

mes

**Kuvendit të Kosovës,
Fondacionit ERSTE, dhe
OJQ TOKA**

2016 – 2017

**PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT
“PUNËTORITË PËR DEMOKRACI / DEMOS-TI”
TË KUVENDIT TË KOSOVËS**

I SUBJEKTI I MEMORANDUMIT

Palët nënshkruese të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) u dakorduan që në mënyrë reciproke të mbështesin zbatimin, fuqizimin dhe promovimin e projektit "Punëtoritë për Demokraci/Demos-Ti" në Kosovë, i cili synon të nxisë interesin e të rinjve për politik dhe procese demokratike dhe përmes një përmbajtje interaktive të mundësoj njohjen me punën e deputetëve dhe kuvendit si institucion, e të kontribuoj në të kuptuarit më të mirë të tyre. Përveç të mësuarit të parimeve themelore të demokracisë dhe ofrimit të njohurive për proceset parlamentare, programi synon të shpjegoj dy parakushtet e tjera për pjesëmarrje në politik: kompetencën para mediave dhe gatishmërinë për të shprehur një mendim

Projekti "Punëtoritë për Demokraci/Demos-Ti" është projektuar si program për edukimin qytetar të fëmijëve të shkollave fillore dhe të mesme, përmes të cilit ata fitojnë njohuri për demokracinë në kuvend, funksionimin e kuvendit, miratimin dhe zbatimin e një ligji si dhe rolin e mediave në një shoqëri pluraliste. Projekti zbatohet në formë të punëtorive, ku fëmijët e moshës së shkollës fillore (tetë deri në katërbëdhjetë/pesëmbëdhjetë vjet) me ndihmën e trajnerëve të trajnuar e përmes një përmbajtje interaktive dhe në mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre mësojnë se si funksionon demokracia. Njohuritë dhe përshtypjet e fituara inkorporohen në një gazetë, transmetohen përmes radios, apo një video e cila më pas publikohet në faqen e internetit të kuvendit të fëmijëve. Zhvillimi i mëtejshëm i projektit mund të përfshijë edhe rritjen e numrit të temave që do të mbulohen nga punëtoritë. Me iniciativë të ish-Kryetares së Parlamentit të Austrisë Znj. Barbara Prammer, Fondacioni ERSTE, programet e të cilit fokusohen në fuqizimin e demokracisë dhe shoqërisë civile në Evropën Qendrore dhe Juglindore ka njohur cilësinë e projektit "Punëtoritë për Demokraci" që është zbatuar në Parlamentin Austriak që nga vitit 2007 dhe në Parlamentin Malazez që nga viti 2012, ka vendosur të mbështes zbatimin e projektit në Kosovë.

Mbështetja teknike dhe profesionale ofrohen nga OJQ TOKA, në bashkëpunim të ngushtë me palët nënshkruese të këtij MM.

II QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është krijimi i marrëdhënieve formale ndërmjet palëve nënshkruese dhe në lidhje me zbatimin e projektit "Punëtoritë për Demokraci/Demos-Ti" në Kosovë.

Objektivat e bashkëpunimit janë:

1. Nxitja e interesit të të rinjve për politik dhe procese demokratike;
2. Krijimi i mundësisë për të rinjtë që përmes një përmbajtje interaktive të njoftohen me punën e deputetëve dhe Kuvendit si institucion;
3. Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve, nga tetë deri në katërbëdhjetë/pesëmbëdhjetë vjeç, që të mësojnë nëpërmjet përmbajtjes interaktive se si funksionon demokracia dhe në këtë mënyrë të ndihmojë në zbatimin e projektit "Punëtoritë për Demokraci/DEMOS-Ti";
4. Forcimi i bashkëpunimit me OJQ-në e cila ka qenë e përfshirë në edukimin e të rinjve;
5. Sigurimi i pjesëmarrjes në baza vjetore të nxënësve të shkollave fillore nga të gjitha komunat e Kosovës.

III AKTIVITETET PËR ARRITJEN E BASHKËPUNIMIT

Të gjitha palët nënshkruese kanë rënë dakord për zbatimin e aktiviteteve vijuese të përcaktuara me MM:

Kuvendi i Kosovës do të:

1. Të ofrojë një hapësirë të përshtatshme për punëtoritë, me të njëjtat kushte sipas të cilave është financuar qiraja e hapësirës deri më tani nga Fondacioni ERSTE, duke i transferuar fondet tek OJQ TOKA për këto nevoja në mënyrë periodike, duke filluar që nga 01 janari 2017;
2. Në përputhje me objektivat dhe qëllimet finale të projektit, krahas përpjekjeve dhe mundësive të saja më të mira të mundësoj financimin e plotë të projektit dhe të përfshijë të paktën tetë trajnerë të trajnuar më parë në kuadër të strukturave të saja institucionale që nga 01 janari 2018;
3. Të kontribuoj në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të cilat do të zbatohen në kuadër të projektit;
4. Të sigurojnë vizitën e deputetëve dhe stafit të shërbimit parlamentar si mysafirë të punëtorive të demokracisë, sipas disponueshmërisë së tyre;
5. Të miratojë të gjitha përmbajtjet e publikuar në faqen e internetit (faqja e Kuvendit të fëmijëve), si dhe materialet të cilat përdoren për qëllime promovuese;
6. Ofrimi i trajnimeve për trajnerët mbi procedurat dhe metodat e punës së Kuvendit;
7. Të organizojë vizita në ambientet e Kuvendit, sipas mundësive, brenda katër orëve të punëtorisë.

Fondacioni ERSTE do të:

1. Mundësoj dhe do të mbështes financiarisht realizimin e aktiviteteve të planifikuara të projektit në përputhje me kapacitetet e saj financiare dhe brenda afatit të caktuar kohor të këtij Memorandumi, duke përfshirë mbajtjen dhe mbështetjen e trajnimeve të nevojshme për trajnerët e "Punëtorive për Demokraci/Demos-Ti" në Kosovë, në bashkëpunim me agjencinë e arsimit

Müllers Freunde e cila vazhdimisht ofron ekspertizë të zgjeruar në zbatimin e projektit në Parlamentin e Austrisë dhe Parlamentin e Malit të Zi;

2. Ofroj, përmes donacioneve dhe në përputhje me kapacitetet e saj financiare, pajisje teknike të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e radio dhe video reportazheve për fëmijë dhe reportazheve në gazeta, të cilat realizohen si rezultat i punëtorive;

3. Kontribuoj në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve që do të zbatohen si rezultat i projektit në përputhje me kapacitetet e saj financiare.

OJQ TOKA do të:

1. Zbatoj aktivitetet e përcaktuara nga koncepti kyç i projektit "Punëtoritë për Demokraci/ Demos-Ti" ashtu siç është përcaktuar nga agjencia e arsimit Müllers Freunde në Parlamentin e Austrisë dhe atë të Malit të Zi;

2. Përcaktoj, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat fillore, oraret më të përshtatshme për pjesëmarrjen e shkollës dhe klasave individuale në punëtori dhe do të dorëzoj atë me kohë në Kuvend;

3. Përpilon një formular për dhënie të pëlqimit - për prindërit - për pjesëmarrje të fëmijëve të tyre në projekt;

4. Organizon transport të duhur të përshtatshëm për nxënësit nga shkolla në mjediset e punëtorisë dhe kthimin mbrapa;

5. Zgjidh një person i cili do të hartoj një identitet të duhur vizual për projektin (logo, etj.);

6. Ofron meze dhe pije freskuese për fëmijët gjatë qëndrimit të tyre në punëtori;

7. Zhvillon një uebfaqe (uebfaqe të Kuvendit të fëmijëve), ku do të publikohet e gjithë puna e realizuar nga punëtoritë;

8. Ofrimi i trajnimeve për ndihmë të parë për trajnerët e punëtorive;

9. Siguron furnizim me orendi, pajisje dhe me të gjitha furnizimet tjera të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara;

10. Krijoj materiale të përshtatshme promovuese (fletëpalosje, video promovuese, etj.).

Të gjithë nënshkruesit bashkërisht do të:

1. Mbështesin dhe fuqizojnë aktivitetet e pjesëmarrësve të "Punëtorive për Demokraci/Demos-Ti";
2. Bëjnë përzgjedhjen e individëve të cilët do të punojnë drejtpërdrejt me fëmijët;
3. Kontribuojnë për promovim në media dhe promovime tjera publike të "Punëtorive për Demokraci/Demos-Ti";
4. Bashkëpunojnë dhe vazhdimisht do të fuqizojnë marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet nënshkruesve të MM;
5. Kontribuojnë në mënyrë aktive në zbatimin dhe realizimin e "Punëtorive për Demokraci/Demos-Ti", si dhe shkëmbimin e rregullt të informacionit përkatës;
6. Emërojnë një person zyrtar kontaktues dhe koordinator të aktiviteteve për zbatimin e kësaj MM-je.

IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ky MM është arritur në mirëbesim dhe në besim të ndërsjellë. Është hartuar për të ofruar një bazë ligjore dhe afat kohor për adresimin e projektit nga Fondacioni ERSTE dhe OJQ Toka në Kuvendin e Kosovës, me përpjekje të përbashkëta të të gjithë palëve nënshkruesve, siç u tha më parë.

Marrëdhënia ndërmjet nënshkruesve si dhe mbështetja që do të ofrohet nga çdo anë do të vazhdojë deri në marrjen zyrtare të përgjegjësive për aktivitete të projektit nga ana e Kuvendit të Kosovës, siç është cekur më poshtë.

V AFATI KOHOR I MM-së


Ky MM do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit. MM do të jetë në fuqi gjatë periudhës së nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit, me mbështetjen financiare të Fondacionit ERSTE si dhe realizimit profesional dhe teknik të OJQ Toka.

Pas periudhës fillestare të financuar nga Fondacioni ERSTE (Fundi i vitit 2017), pritet që projekti të arrij qëndrueshmërinë e plotë, përkatësisht për Kuvendin e Kosovës që të jetë në gjendje të vazhdojë të zbatohet dhe të ofroj financim të plotë për të gjitha aktivitetet e projektit.


Të gjithë nënshkruesit konfirmojnë dhe pajtohen që të përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre, siç përcaktohen në këtë MM.

Ky Memorandum është përgatitur në gjashtë (6) kopje, me tre (3) kopje në gjuhën angleze.


Prishtinë, 06 korrik 2016



Kadri Veseli
Kryetar i Kuvendit të Kosovës



Erhard Busek
Bordi Këshillues, Fondacioni ERSTE



Jehona Gjurgjeala
Drejtoreshë Ekzekutive, OJQ TOKA